



STATUTI

I

URDHRIT TË STOMATOLOGËVE TË SHQIPËRISË

---

**DOKUMENT THEMELTAR**

**Statuti i Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë**  
**Kodi i Etikës dhe i Deontologjisë Stomatologjike**

**Për hartimin e Statutit dhe Kodit punuan:**

**Dr. Nikoll DEDA**

**Presidenti i USSH**

**Av.Viktor Gumi**

**"Gumi & Associates"**

**Alban Peca**

**Sekretar i Përgjithshëm i USSH**

**Redaktoi: Zamira Dauti (Kasa)**

**Asistent**

Shtëpia Botuese:

ISBN:

Design & Layout:

© Copyright USSH, 2023

Adresa: Urdhri i Stomatologëve të Shqipërisë

Rr. "E DIBRËS", Nd. 10, H. 5, Ap. 1/1. Njësia Administrative Nr. 8, 1017, Tiranë, Shqipëri

Tel: 0035542223443

e-mail: [info@ussh.org.al](mailto:info@ussh.org.al)

Website: <http://www.ussh.org.al>

Statuti i Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë (më tej Urdhri ose USSH) është i bazuar në Ligjin Nr. 127 datë 02.10.2014“Për Urdhrit e Stomatologëve në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës.

## ***KREU I***

### ***DISPOZITA TË PËRGJITHSHME***

#### ***Neni 1***

##### ***Qëllimi***

Ky Statut ka për qëllim rregullimin normativ të të gjithë veprimtarive të Urdhrit të Stomatologëve, organeve të tij, si një akt i brendshëm për zbatimin e Ligjit dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë në bazë të tij.

#### ***Neni 2***

##### ***Fusha e zbatimit***

Ligji nr.127, dt.2.10.2014 “Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë” e përkufizon Urdhrit si ent publik, që përfaqëson interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.

USSH-ja është autoritet i vetërregullimit profesional, i pavarur, i depolitizuar, i hapur dhe i barabartë për të gjithë anëtarët, pavarësisht përkatësisë së tyre racore, etnike, fetare, apo bindjeve politike.

Ndalohet kategorikisht, që në organet dhe strukturat e të gjitha niveleve të Urdhrit të reflektohen dukuri, ose të diskutohen probleme me karakter politik, partiak, racor, etnik e fetar.

#### ***Neni 3***

##### ***Statusi***

Urdhri i Stomatologëve në Republikën e Shqipërisë është **ent publik**, jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesionistëve stomatologë dhe ndihmësstomatologë dhe rregullon marrëdhëniet juridike dhe etiko-profesionale midis tyre dhe në funksion të publikut.

## **KREU II**

### **MISIONI DHE BUXHETI**

#### ***Neni 4***

#### ***Misioni***

1. Misioni i Urdhrit të Stomatologëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve në fushën e stomatologjisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të stomatologut.
2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Stomatologëve ushtron këto kompetenca:
  - a. jep dhe heq licencën individuale të ushtrimit të profesionit;
  - b. vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo stomatolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;
  - c. rivlerëson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit të Stomatologëve përballë standardeve të vendosura;
  - d. nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional dhe etik të anëtarëve të Urdhrit;
  - e. bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, institucione të tjera shkencore dhe arsimore për të siguruar standarde të larta në Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të anëtarëve të Urdhrit;
  - f. krijon dhe mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit, i cili është i ndarë në pjesë të veçanta për stomatologët dhe ndihmësstomatologët dhe menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij;
  - g. mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit të stomatologut.

#### ***Neni 5***

#### ***Kriteret e anëtarësisë***

1. Janë anëtarë të Urdhrit të Stomatologëve të gjithë stomatologët që ushtrojnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:
  - a) të jenë shtetas shqiptarë;

- b) të kenë diplomën e stomatologut, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë brenda apo jashtë shtetit, i njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin;
  - c) në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale;
  - ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim që do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik;
2. Stomatologut, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion shëndetësor, ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, i duhet edhe:
- a) leja e qëndrimit dhe leja e punës në Republikën e Shqipërisë;
  - b) Çertifikata e Mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga urdhri/dhoma apo shoqata e stomatologëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka masa ndëshkimore;
  - c) njehsimi (konvalidimi) i diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj;
  - ç) rekomandimi nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Stomatologëve;
  - d) njohja e gjuhës shqipe, e vërtetuar me dëshmi nga një autoritet i licencuar nga shteti. Stomatologu jorezident detyrimisht duhet të punojë me përkthyes;
3. Ndhmësstomatologët regjistrohen në një regjistër të veçantë të Urdhrit;
- Ndhmësstomatologu për tu regjistruar në Urdhrin e Stomatologëve duhet të plotësojë këto kritere:
- a) të ketë një diplomë për ndhmësstomatolog, të njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin.
  - b) në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.
  - c) të njohë dhe të zotohet me shkrim që do të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.
4. Urdhri, me akte të veçanta, përcakton mënyrën e regjistrimit të anëtarëve, të evidentimit e të mirëmbajtjes së regjistrave, përmbajtjen e tyre dhe formën e shkresave, vërtetimeve e akteve të tjera, si dhe vulën e Urdhrit, në bazë të evidencës zyrtare.

## ***Neni 6***

### ***Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit***

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e stomatologut dhe të ndhmësstomatologut në sistemin e kujdesit shëndetësor, publik apo privat, në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Stomatologëve dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.

2. Anëtari i Urdhrit ka këto detyrime:

a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e shëndetësisë, Statutin e Urdhrit të Stomatologëve dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik;

b) të punojë pa ndërprerje për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit në vazhdim mjekësor;

c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.

### ***Neni 7***

#### ***Bashkëpunimi***

1. Urdhri i Stomatologëve, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë e institucionet në varësi të saj dhe me ministritë, institucionet qendrore dhe organizma të tjerë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, publikë ose jopublikë.

2. Urdhri i Stomatologëve bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë.

3. Urdhri i Stomatologëve informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrit e Stomatologëve për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.

### ***Neni 8***

#### ***Buxheti***

1. Urdhri i Stomatologëve ka buxhetin e tij, të cilin e miraton Asambleja Kombëtare dhe e administron vetë Urdhri në përputhje me rregullat financiare në fuqi. Burimet financiare të Urdhrit të Stomatologëve janë:

a) kuotizacionet e anëtarëve;

b) tarifat e regjistrimit dhe të dhënies së të drejtës individuale për ushtrimin e profesionit, vërtetime dhe dokumente të tjera, për të cilat urdhri mban evidencë zyrtare;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

2. Të ardhurat e siguruara sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i Stomatologëve i përdor për të përmbushur misionin e tij në përputhje me Statutin dhe me këtë ligj.

### **KREU III**

#### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI**

##### ***Neni 9***

##### ***Organet kryesore***

1. Organet kryesore të Urdhrit të Stomatologëve janë:

a) Asambletë;

b) Këshillat;

c) Komisionet Disiplinore;

ç) Presidentët e Urdhrit.

2. Zgjedhjet në organet e sipërpërmendura duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30

për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri".

##### ***Neni 10***

##### ***Asambleja Kombëtare e USSH***

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës i Urdhrit dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e Këshillave Rajonale.

Mbledhja e Asamblesë Kombëtare të USSH thirret nga:

- Presidenti i Këshillit Kombëtar;
- Kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të Asamblesë.

##### ***Asambletë rajonale të USSH***

Numri i anëtarëve përfaqësues në 7 rajone të USSH në vendin tonë:

a-Asambleja Rajonale USSH Tiranë: 100 anëtarë;

b-Asambleja Rajonale USSH Elbasan – Korçë: 50 anëtarë;

c-Asambleja Rajonale USSH Fier - Berat: 50 anëtarë;

d-Asambleja Rajonale USSH Vlorë - Gjirokastër: 50 anëtarë;

e-Asambleja Rajonale USSH Durrës -Kavajë: 50 anëtarë;

f- Asambleja Rajonale USSH Lezhë -Dibër: 35 anëtarë;

g-Asambleja Rajonale USSH Shkodër -Kukës: 35 anëtarë.

2- Asambleja Rajonale është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës i Urdhrit për Rajonin. Asambleja Rajonale zgjedh këshillin rajonal.

3 -Presidenti i USSH, thërret mbledhjet e asambleve rajonale të USSH për zgjedhjet e këshillave rajonale të USSH.

***Përbërja e anëtarëve të Asamblesë Rajonale orientohet nga këto kritere kryesore:***

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë mbushur moshën 30 vjeç;
3. Të ketë mbi 5 vjet i regjistruar në Urdhrin e Stomatologëve;
4. Të ketë reputacion etiko-moral dhe profesional;
5. Të ketë aftësi komunikuese dhe të ketë shfaqur korrektësi në zbatimin e normave dhe rregullave në jetën shoqërore, në komunikimin me publikun, pacientët, kolegët, si dhe me drejtuesit;
6. Të mos jetë ndëshkuar për vepra penale, si dhe gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të mos jetë ndëshkuar për shkelje të ushtrimit të profesionit;
7. Gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të mos jetë ndëshkuar për shkelje të ushtrimit të profesionit si dhe për shkelje disiplinore dhe organizative në institucionet e zgjedhura të USSH;
8. Të mos ketë funksione drejtuese në administratën shtetërore dhe të mos bëjë pjesë në forume drejtuese partiake të çdo niveli qofshin.

***Neni 11***

***Këshilli Kombëtar***

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë përbëhet nga 25 anëtarë, ndër të cilët 20 janë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë dhe 5 të tjerët janë: Presidenti i Urdhrit të Stomatologëve, zëvendësi i tij, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe një përfaqësues i institucioneve të arsimit të lartë publik.

Presidenti i sapozgjedhur i Urdhrit cakton përfaqësuesin e institucionit të arsimit të lartë publik, i cili nuk duhet të ketë funksion drejtues administrativ. Ai duhet të jetë pedagog efektiv në institucionin e arsimit të lartë publik, me eksperiencë të spikatur pedagogjike e profesionale dhe preferohet të mbajë titullin Profesor Doktor.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:
  - a) miraton strukturën e vet organizative dhe të Këshillave Rajonalë;
  - b) zgjedh Presidentin e Urdhrit të Stomatologëve dhe zëvendësin e tij;
  - c) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
  - ç) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar, duke përcaktuar fondet në administrimin e Këshillave Rajonalë;
  - d) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
  - dh) mbikëqyr dhe ndërhyr në rregullimin e marrëdhënieve të punës të stomatologëve me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;
  - e) miraton Statutin, rregulloret e Urdhrit si dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik.

## ***Neni 12***

### ***Këshilli Rajonal***

1. Këshilli Rajonal përbëhet nga 5 deri në 9 anëtarë, në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Stomatologëve në rajon.

Anëtarët e Këshillit propozohen dhe zgjidhen nga Asambleja Rajonale.

2. Këshilli rajonal ka këto funksione:
  - a) mbikëqyr dhe ndërhyr në rregullimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet stomatologëve dhe ndihmësstomatologëve në sektorin publik dhe privat në rajon;
  - b) administron buxhetin dhe të gjitha pasuritë e Urdhrit në nivel rajoni të cilat janë të përcaktuara në “shifra konkrete” nga Këshilli Kombëtar i USSH, sipas parshikimeve në Statut, neni 17, pika 4, “Kopetencat e Këshillit Kombëtar”.
  - c) cakton komisionin disiplinor në nivel rajoni.
3. Këshilli rajonal i USSH pajis stomatologët me liçensën për ushtrimin individual të profesionit në stomatologji me afat skadence 5 vjeçare në referencë të dosjes individuale të stomatologut të depozituar në arkivën qendrore të USSH dhe numrit në Regjistrin Themeltar të USSH pasi mbaron afati i liçensës të marrë për herë të parë nga Këshilli Kombëtar.
4. Zgjedhjet për këshillin rajonal bëhen çdo 5 vjet.



## **Neni 13**

### **Presidentët e Urdhrit**

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative, të cilat propozohen nga Asambleja Kombëtare të USSH.
2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Stomatologëve me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i Presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.
3. Këshillat rajonalë zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonalë. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Stomatologëve duhet të përmbushin këto kritere:
  - a. të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
  - b. të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;
  - c. të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
  - d. të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
  - e. të kenë kryer botime shkencore në fushën e stomatologjisë;
  - f. të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
5. Funkzioni i presidentëve të Urdhrit të Stomatologëve është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.
6. Presidentët e Urdhrit e përfundojnë mandatin e tyre përpara kohe në këto raste:
  - a. shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit Kombëtar ose këshillit rajonal, me jo më pak se dy të tretat e anëtarëve;
  - b. japin dorëheqjen;
  - c. dënohen me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - d. humbasin zotësinë e plotë për të vepruar;
  - e. bëhen të paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tyre, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.
7. **Procedura e zgjedhjes së Presidentit të Këshillit Kombëtar:**
  - a) Presidenti i Këshillit Kombëtar i U.S.SH-së, duhet të propozohet nga jo më pak se 20 % e anëtarëve të Asamblesë Kombëtare, kundrejt firmave përkatëse. Komisioni i verifikimit të mandateve i Asamblesë Kombëtare kualifikon dosjet e kandidatëve për president, që t'i propozohet për votim Këshillit Kombëtar;

- b) Zgjedhja e Presidentit të Këshillit Kombëtar bëhet në të njëjtën ditë dhe datë me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar;
- c) Thirrja e mbledhjes së Këshillit Kombëtar bëhet nga Presidenti në detyrë ndërsa Këshilli Kombëtar në mbledhjen e tij të parë do të drejtohet nga anëtari më i madh në moshë ose një anëtar tjetër i përfaqësues në moshë;
- d) Presidenti i USSH qëndron në detyrë derisa të bëjë betimin Presidenti i zgjedhur i USSH.

## ***Neni 14***

### ***Komisionet disiplinore***

1. Pranë Këshillave Rajonalë dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë Komisionet Disiplinore, si organizma të gjyqimit profesional. Komisioni Disiplinor Rajonal përbëhet nga 7 anëtarë të zgjedhur nga këshilli rajonal. Komisioni Disiplinor Kombëtar përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.
2. Mënyra e ngritjes dhe e funksionimit të Komisioneve Disiplinore përcaktohet në Rregulloren e Gjyqimit Profesional, e cila miratohet nga Këshilli Kombëtar.
3. Komisioni verifikon dhe shqyrton ankesat e çdo personi për shkeljet e Kodit Etik Deontologjik Stomatologjik, si dhe për gabime profesionale të anëtarëve të Urdhrit të Stomatologëve.
4. Komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonalë, ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në Komisionin Disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

## ***Neni 15***

### ***Masat disiplinore***

1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe seancës dëgjimore. Kur nuk kemi të bëjmë me një vepër penale dhe vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit Etik Deontologjik Stomatologjik ose ka bërë gabime teknike, komisioni jep këto masa:
  - a) vërejtje me shkrim;
  - b) vërejtje me paralajmërim;
  - c) gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë;
  - ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore, publike dhe private;
  - d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologëve deri në 3 vjet;
  - dh) përjashtim nga Urdhri i Stomatologëve për një periudhë deri në 3 vjet;

2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Komisioni ka të drejtë tu caktojë të ndëshkuarëve, si masë plotësuese, kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite.
3. Masat e sipërpërmendura disiplinore mund të shlyhen në qoftë se, brenda 1 viti nga dita e dhënies së tyre për shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, dhe brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.
4. Gjoha e vendosur sipas shkronjës “c”, të pikës 1, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

### ***Neni 16***

#### ***Ankimi***

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i këshillit rajonal, paraqiten në Komisionin Disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologëve brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.
2. Komisioni Disiplinor, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i Komisionit Disiplinor të Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

### ***Neni 17***

#### ***Detyrat e Këshillit Kombëtar***

Këshilli Kombëtar i USSH, udhëheq dhe mbikqyr të gjithë veprimtaritë e Urdhrit. Për përmbushjen e misionit të tij, Këshilli Kombëtar:

- 1) harton dhe miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike dhe organizon mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij;
- 2) harton dhe miraton Statutin dhe rregulloret e funksionimit të këshillave dhe strukturave të tjera të Urdhrit;
- 3) miraton strukturat organizative dhe administrative të Urdhrit në nivel kombëtar dhe rajonal;
- 4) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar, duke përcaktuar fondet në administrimin e këshillave rajonalë;
- 5) përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të profesionistëve stomatologë/ndihmësstomatologë në funksion të ushtrimit të lirë dhe autonom të profesionit;
- 6) miraton strategjitë e zhvillimit të Urdhrit dhe me anë të strukturave të veta organizon zbatimin e tyre;
- 7) sensibilizon dhe informon opinionin publik për misionin dhe funksionet e Urdhrit si dhe deklaron pozicionimet e tij për probleme dhe situata të veçanta sa i takon misionit dhe atributëve të tij;

- 8) nxit dhe bashkëpunon me faktorë dhe aktorë të tjerë të sistemit për standarde të larta të edukimit dhe formimit profesional të stomatologëve / ndihmësstomatologëve dhe përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor;
- 9) Këshilli Kombëtar i USSH mbledhet një herë në tre muaj (ose katër herë në vit) duke përjashtuar mbledhjet e jashtëzakonshme të thirrura nga Presidenti i Këshillit Kombëtar. Njoftimi për mbledhjet e Këshillit Kombëtar bëhet 7-14 para datës së caktuar ndërsa për mbledhjet e jashtëzakonshme deri 24 orë para orës së mbledhjes.
- 10) Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Kombëtar bëhen me postë zyrtare ose postë elektronike (e-mail dhe çdo forëm tjetër komunikimi).

### ***Neni 18***

#### ***Vendimet e Këshillit Kombëtar***

Vendimet e Këshillit Kombëtar janë të detyrueshme për të gjitha strukturat dhe nivelet e Urdhrit.

### ***Neni 19***

#### ***Aparati Qendror i Këshillit Kombëtar***

Aparati Qendror i Këshillit Kombëtar të USSH koordinon dhe kontrollon veprimtaritë e Këshillave Rajonalë, veprimtaritë tekniko-administrative dhe ekonomike-financiare të Urdhrit. Siguron dhe kontrollon zbatimin dhe respektimin e ligjeve, si dhe të Statutit e Rregulloreve të Urdhrit. Siguron dhe kontrollon zbatimin e Vendimeve të Këshillit Kombëtar, si dhe:

1. shqyrton dhe përcakton në Bordin Drejtues kuotizacionet e anëtarësisë, pagat, honoraret, tarifatat e regjistrimit, anëtarësimin, tarifatat për Liçensën për ushtrimin individual të profesionit dhe pagesa të tjera, të cilat i parashtron për vendimmarrje në Këshillin Kombëtar;
2. organizon dhe mbikqyr procesin e regjistrimit, anëtarësimin dhe administrimit të Regjistrimit të Stomatologëve në nivel kombëtar e rajonal;
3. mbikqyr veprimtaritë për pajisjen e stomatologëve me Liçensën për ushtrimin individual të profesionit dhe përcakton kriteret për lëshimin e saj;
4. emëron ose miraton sipas kriterëve të specifikuar në këtë Statut, komisione apo grupe të tjera pune me karakter të përhershëm, të cilat i miraton me Vendim të Këshillit Kombëtar;
5. drejton dhe mbikqyr sistematikisht veprimtaritë e Këshillave Rajonalë;
6. organizon veprimtari shkencore, trajnime e seminare kualifikuese për drejtues të strukturave të Urdhrit, anëtarë komisionesh dhe punonjës të tjerë;

7. i propozon Këshillit Kombëtar, anëtarë të Urdhrit për dekorime, vlerësime të ndryshme dhe shpërblime;

8. organizon dhe mban marrëdhënie me organizma e forume ndërkombëtare dhe ratifikon në Këshillin Kombëtar marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi me to;

9. nxjerr Buletinin e Urdhrit, si dhe botime të tjera.

## **Neni 20**

### ***Bordi Drejtues i Aparatit Qëndror të Këshillit Kombëtar***

Bordi Drejtues i USSH përbëhet nga:

1)Presidenti i USSH, Kryetar Bordi;

2)Zv.Presidenti i USSH;

3)Sekretari i Përgjithshëm i USSH;

4)Përgjegjësi i Sektorit të Financës i USSH;

5)Përgjegjësi i Sektorit të Liçensimit i USSH;

6)Përgjegjësi i Sektorit të Inspektim – Monitorimit i USSH.

a- Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH propozon në Bordin e USSH projekt-vendimet që i çmon të rëndësishme për vendimmarrje në bord, e më pas miratimi në Këshill Kombëtar.

b-Presidenti i USSH propozon dhe votëbeson në bordin e USSH projektvendimin për nderprerjen e kontratës së punës të nëpunësve të administratës qendrore të USSH.

c-Presidenti i USSH thërret dhe përcakton rendin e ditës për mbledhjet e Këshillit Kombëtar dhe Bordit të USSH.

d-Të gjitha vendimet e bordit kalojnë në votim të hapur përveç rasteve që bordi vendos me shumicë votash për votim të fshehtë.

e-Presidenti i USSH, projektvendimin për largimin parakohe të Sekretarit të Përgjithshëm, e miraton me votim në bord.

f-Sekretari i Përgjithshëm i USSH, kriter bazë për emërimin e tij, duhet të jetë i diplomuar në jurisprudencë dhe me një provojë pune jo me pak se 5 vjet.

## **Neni 21**

### ***Presidenti i Këshilli Kombëtar***

Presidenti i Këshillit Kombëtar ka këto detyrat dhe kompetenca:

1. Drejton dhe mbikëqyr të gjithë veprimtaritë e Urdhrit.
2. Nxjerr urdhëresa e udhëzime për zbatimin e Vendimeve të Këshillit Kombëtar dhe çështje të tjera për mbarëvajtjen e punës.
3. Thërret mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Kombëtar dhe të Bordit Drejtues.
4. Thërret mbledhjet e jashtëzakonshme të Asamblesë Kombëtare, Këshillit Kombëtar dhe të Këshillave Rajonalë.
5. Presidenti i USSH thërret dhe përcakton rendin e ditës për mbledhjet e Këshillit Kombëtar dhe Bordit të USSH.
6. Në kuadër të marrëdhënieve me institucionet e administratës shtetërore, si dhe organe e organizma të tjera brenda e jashtë vendit, përfaqëson Këshillin Kombëtar, shprehet dhe bën propozime në emër të tij. Në mungesë të tij, ia delegon këto kompetenca zëvendës Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm, apo një personi tjetër.
7. Propozon kandidatura për tu zgjedhur, kooptuar ose shkarkuar në organet e Urdhrit si dhe bën propozime për dekorime, vlerësime, shpërblime, ndihma etj.
8. I autorizon të drejtën e nënshkrimit për Urdhrin zëvendës Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm.
9. Pasi t'i ketë shqyrtuar me Bordin Këshillimor, duke marrë në konsideratë edhe mendimet dhe sugjerimet e këtij të fundit, emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm, si dhe punonjësit e Aparatit që nuk janë të zgjedhur.
10. Midis dy mbledhjeve të Këshillit Kombëtar merr vendime në emër të tij. Këto vendime i ratifikon në mbledhjen më të afërt të Këshillit, ose në të kundërt ato shfuqizohen.
11. Thërret grupe pune, apo individë për udhëzime, raportime, konsultime dhe detyra të ndryshme.
12. Thërret drejtues institucionesh, shërbimesh apo stomatologë, kur ka ndodhi të ndryshme në shërbimet e tyre, nga të cilët informohet për ngjarjet dhe sipas rastit i këshillon, i paralajmëron ose i relaton për proces disiplinor në Urdhrin e Stomatologëve, ose në institucionet sipas varësisë së tyre.
13. Presidenti i USSH, thërret mbledhjet e asambleve rajonale të USSH për zgjedhjet e këshillave rajonale të USSH.

## ***Neni 22***

### ***Sekretari i Përgjithshëm***

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjësi kryesor për problemet tekniko-organizative të Këshillit Kombëtar dhe të Aparatit të tij.

Ai mund të jetë vetëm jurist dhe me një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjeçare.

Sekretari i Përgjithshëm kryen këto detyra:

1. Drejton dhe kontrollon mbarëvajtjen e punës në Aparatin Qendror të Këshillit Kombëtar.
2. Mban kontakte me këshillat rajonale dhe koordinon veprimtarinë e tyre.
3. Kujdeset për krijimin dhe organizimin e komisioneve dhe grupeve të punës dhe kontrollon veprimtarinë e tyre.
4. Organizon dhe drejton punën për hartimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike, të rregulloreve për veprimtaritë e Këshillave të Urdhrit dhe Aparatit Qendror.
5. Organizon mbledhjet e Këshillit Kombëtar, të Bordit Këshillimor, të komisioneve e grupeve të punës, si dhe veprimtari të tjera.
6. Organizon marrëdhëniet publike dhe kontaktet me institucionet shtetërore dhe jo shtetërore të vendit, si dhe me organizata e forume ndërkombëtare.
7. Raporton dhe informon sistematikisht Presidentin dhe Këshillin Kombëtar lidhur me mbarëvajtjen e punës dhe detyrat specifike të Tij.
8. Organizon dhe drejton punën për daljen e Buletinit dhe kujdeset për botime të tjera. Për mbulimin e këtyre detyrave, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet tek Aparati Qendror, si dhe krijon grupe pune e komisione të ndryshme.

### **Neni 23**

#### **Këshillat Rajonalë**

Këshilli Rajonal është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës i USSH të Rajonit midis dy mbledhjeve të Asamblesë Rajonalë.

Shqipëria ndahet në 7 Këshilla Rajonalë.

- a) Këshilli Rajonal përbëhet nga 5-7 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Rajonale. Këshilli Rajonal i Tiranës përbëhet nga 7-9 anëtarë.
- b) Anëtarë të kooptuar nga vetë Këshilli për zëvendësim të anëtarëve që eventualisht janë larguar;
- c) Në raste kur ka listë shumëemërore procedohet sipas saj.

**Këshilli Rajonal zgjedh Presidentin dhe Zëvendësin i tij.** Mandati i Presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje një herë. Funkzioni i tyre është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese të administratës shtetërore, apo forume drejtuese partiake.

Këshilli Rajonal, me propozim të presidentit dhe pëlqimin e këshillit përkatës rajonal, emëron dhe shkarkon Sekretarin e tij, i cili duhet të jetë me arsim të lartë, jurist, ekonomist, stomatolog.

- d) Presidenti, zv.Presidenti dhe sekretari i këshillit rajonal, përbëjnë kryesinë e këshillit rajonal.

**Për të përmbushur funksionet e detyrat e tij këshilli rajonal:**

1. Krijon dhe mban të azhurnuar Regjistrin e Stomatologëve duke pasqyruar në të çdo ndryshim në karrierën e tyre profesionale.
2. Pajis stomatologët me Liçensën për ushtrimin individual të profesionit.
3. Siguron zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve të Këshillit Kombëtar apo të Aparatit Qendror të tij.
4. Kryen veprimtaritë për njohjen dhe ndërgjegjësimin e bashkësisë së stomatologëve të juridiksionit të vet me aktet normative, misionin, synimet, funksionet dhe detyrat e Urdhrit.
5. Analizon periodikisht veprimtaritë e Urdhrit dhe organizmave të tij në Rajon.
6. Bazuar në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional të USSH, organizon proceset disiplinore të shkallës së parë.
7. Sensibilizon dhe informon publikun për funksionin dhe kompetencat e Urdhrit, me veprimtari të drejtpërdrejta me kontigjente të publikut ose nëpërmjet mediave.
8. Krijon komisione apo grupe pune të përkohshme në përputhje me veprimtarinë e tij.
9. Për këtë njofton paraprakisht Aparatin Qëndror të Këshillit Kombëtar.
10. Përfaqëson dhe mbron interesat e anëtarësisë lidhur me të drejtën për ushtrimin e lirë e të pavarur të profesionit të stomatologut/ndihmësstomatologut dhe deklaron publikisht opinionet e tij për ngjarje e situata të veçanta mjekësore në rajon brenda limiteve të misionit dhe të funksioneve të Urdhrit.
11. Organizon punën për mbledhjen e kuotizacioneve dhe të detyrimeve të tjera të anëtarëve.
12. Krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore, me organizma joqeveritare brenda rajonit, si dhe me organizata homologe të vendeve fqinje.
13. I propozon Presidentit të Këshillit Kombëtar për probleme e nisma që i quan të domosdoshme për të rritur standardet e shërbimit në rajonin e vetë ose më gjerë.
14. Nxiti dhe mbështet organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore shkencore dhe kualifikuese të stomatologëve të rajonit dhe pjesëmarrjen e tyre në programet e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor.
15. I propozon Këshillit ose Presidentit të Këshillit Kombëtar për dekorime, vlerësime, shpërblime, si dhe për ndihma në raste fatkeqësish për anëtarët e Urdhrit në juridiksion.
16. Kryesia e këshillit rajonal thërret stomatologë ose / dhe drejtues institucioneesh kur ndaj tyre, apo shërbimeve që ata drejtojnë ka ankesë ose shprehje pakënaqësie, të cilët i njofton për sa sipër, i këshillon dhe sipas rastit relaton, ose i paralajmëron për gjykim disiplinor. Të gjitha këto pasqyrohen në Dosjen personale të stomatologut me protokolle të posaçme.



### ***Thirrja e Këshillit Kombëtar dhe këshillave rajonalë***

Mbledhja e Këshillit Kombëtar thirret nga Presidenti i këtij Këshilli, ose në mungesë të tij nga Zv. Presidenti.

1. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar bëhen një herë në 3 (tre) muaj, 4 (katër) herë në vit. Mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Kombëtar thirret nga Presidenti i Këshillit Kombëtar dhe me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

2. Këshilli Kombëtar ose rajonal mund të zhvillojë mbledhje të jashtëzakonshme për trajtimin e problematikave që kanë karakter emergjent ose vendosin largimin para kohe të një anëtari të tij.

### ***Neni 25***

#### ***Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe të këshillave rajonalë***

Kandidaturat për anëtarë të Këshillit Kombëtar dhe të këshillave rajonalë zgjidhen ndër stomatologët më të dalluar për përkushtim, aftësi dhe autoritet profesional.

#### ***Përzgjedhja e anëtarëve bëhet duke u orientuar nga këto kriteret kryesore:***

- 1) Të jetë shtetas shqiptar.
- 2) Të ketë mbushur moshën 30 vjeç
- 3) Të ketë mbi 5 vjet i regjistruar në Urdhrin e Stomatologëve
- 4) Të ketë reputacion etiko-moral dhe profesional.
- 5) Të ketë aftësi komunikuese dhe të ketë shfaqur korrektësi në zbatimin e normave dhe rregullave në jetën shoqërore, në komunikimin me publikun, pacientët, kolegët, si dhe me drejtuesit.
- 6) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
- 7) Gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të mos jetë ndëshkuar për shkelje të ushtrimit të profesionit si dhe për shkelje disiplinore dhe organizative në institucionet e zgjedhura të USSH.
- 8) Cilësia e anëtarit është e papajtueshme me funksione drejtuese në administratën shtetërore dhe të mos bëjë pjesë në forume drejtuese partiake të çdo niveli qofshin.

### ***Neni 26***

#### ***Largimi i Parakohshëm nga Këshilli***

Anëtari i Këshillit Kombëtar dhe atij Rajonal largohet para kohe nga Këshilli kur:

- 1) Kërkon vetë dorëheqje;
- 2) Dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- 3) Kryen shkelje në ushtrimin e profesionit;
- 4) Shkelje administrativo-disiplinore në organet e zgjedhura të USSH;
- 5) Shpërdoron detyrën;
- 6) Mungon më shumë se 3 (tre) herë në mbledhjet e Këshillit pa shkaqe të arsyetuara;

- 7) Paaftësohet për arsye shëndetësore;
- 8) Paraqet paaftësi në zbatim të detyrave të Asamblesë dhe Këshillit Kombëtar;
- 9) Emërohet apo zgjidhet në detyra drejtuese shtetërore apo partiake që bien ndesh me kriteret e parashikuara në këtë Statut për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe të këshillave rajonalë;
- 10) Për kryerjen e shkeljeve të rënda të etikës si dhe për kryerjen e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e anëtarit dhe veprimtarinë normale të Këshillit.

## **Neni 27**

### ***Propozimi dhe vendimmarrja për largimin e parakohshëm***

Përveç pikës 1, të nenit pararendës, në të gjitha rastet, propozimin për largim kanë të drejtë t'ia paraqesin Këshillit përkatës:

#### **A. *Për anëtarët e këshillave rajonalë:***

1. 1/4 e asamblesë rajonale;
2. jo më pak se 2 (dy) anëtarë të atij këshilli. *Për Këshillin Rajonal të Tiranës, jo më pak se 3 (tre) anëtarë.*
3. Presidenti i këshillit përkatës.

#### **B. *Për presidentët e këshillave rajonalë:***

1. 1/3 e asamblesë rajonale;
2. jo më pak se 3 (tre) anëtarë të këshillit përkatës. *Për Këshillin Rajonal të Tiranës, jo më pak se 4 (katër) anëtarë.*

#### **3. *Presidenti i Këshillit Kombëtar.***

#### **C. *Për anëtarët e Këshillit Kombëtar:***

1. 1/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme;
2. 1/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar;

#### **3. *Presidenti i Këshillit Kombëtar.***

#### **D. *Për Presidentin e Këshillit Kombëtar:***

1. 1/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme;
2. 1/13 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

#### **E. *Në të gjitha rastet për vendimarrje pjesëmarrja është e domosdoshme:***

1. Për largimin para kohe të anëtarëve të Këshillit Kombëtar, vendimi merret me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Për anëtarët e këshillave rajonalë me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve.
2. Për largimin para kohe të Presidentit të Këshillit Kombëtar nevojiten 2/3 e votave e të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar. E njëjta procedurë duhet të ndiqet edhe për presidentët e rajoneve në këshillat përkatës rajonalë.
3. Kur Këshilli Kombëtar vendos largimin e parakohshëm të një anëtari të tij, i cili njëkohësisht është President i Këshillit Rajonal, atëherë këshilli rajonal është i detyruar të zbatojë vendimin e Këshillit Kombëtar dhe detyrimisht zgjedh një president tjetër nga radhët e tij.
4. Kur anëtari i këshillit rajonal është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Kombëtar për fillimin e procedimit disiplinor, duhet të merret miratimi i Presidentit të Këshillit Kombëtar.
5. Kur Këshilli Kombëtar largon para kohe një nga anëtarët e tij si pasojë e një mase disiplinore (jo dorëheqje), atëherë ky i fundit humbet cilësinë edhe te anëtarit të Këshillit Rajonal. Këshilli Rajonal është i detyruar ta zëvendësojë atë edhe si anëtar i Këshillit Rajonal.
6. Kur Këshilli Rajonal përjashton me masë disiplinore një anëtar të tij që është njëkohësisht dhe anëtar i Këshillit Kombëtar, atëherë Këshilli Rajonal i propozon Këshillit Kombëtar largimin e anëtarit të sapo përjashtuar nga këshilli rajonal.
7. Në të gjitha rastet votimi për individëd bëhet i fshehtë.

Për rastet që i përkasin pikës 7 të nenit 26 dhe nenit 27, pika E, 3 dhe 5 largimi është i detyrueshëm dhe nuk votohet.

## ***Neni 28***

### ***Njoftimi për mbledhjet***

1. Presidenti (në mungesë zëvendësi tij) i Këshillit Kombëtar apo rajonal vendos për datën, kohën dhe rendin e ditës së çdo mbledhje.
  - a. Njoftimi për mbledhjet e Këshillit Kombëtar bëhet 7-14 para datës së caktuar ndërsa për mbledhjet e jashtëzakonshme deri 24 orë para orës së mbledhjes.
  - b. Njoftimet për mbledhje të Këshillit Kombëtar, të asambleve dhe Bordit, bëhen në të gjitha format e njoftimit edhe komunikimit, me e-mail, sms ose telefonatë direkte.
  - c. Mbledhjet e Asambleve, Këshillit Kombëtar, ose pjesmarrja në të gjitha organet e zgjedhura të USSH mund të zhvillohet dhe online, e gjithë mbledhja, por edhe një ose disa anëtarë mund të marrin pjesë online (mbledhje hybrid), të diskutojnë e të votojnë online projektvendimet.
2. Në çdo mbledhje duhet të jenë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve të cilët paraprakisht miratojnë rendin e ditës dhe zhvillimin e mbledhjes.

### ***Neni 29***

#### ***Marrja e vendimeve***

Këshilli (Kombëtar apo rajonal) merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur shumica e anëtarëve të pranishëm janë dakort për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

### ***Neni 30***

#### ***Vlefshmëria e mbledhjes***

Mbledhja e Këshillit (Kombëtar apo atij rajonal) është e vlefshme kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve. Kur në hapjen e mbledhjes kjo shumicë nuk arrihet, atëherë Presidenti apo zëvendësi që drejton mbledhjen, vendos thirrjen e mbledhjes një ditë tjetër, duke përsëritur njoftimin me shkrim.

### ***Neni 31***

#### ***Proçesverbali i mbledhjes***

Në çdo mbledhje mbahet një proçesverbal ku shkruhet data, vendi i mbledhjes, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma e rezultati i votimit.

Presidenti i këshillit rajonal apo Kombëtar cakton një person të përhershëm për mbajtjen e proçesverbalit.

Në mbarim të mbledhjes proçesverbali nënshkruhet nga mbajtësi (sekretari) dhe Presidenti i Këshillit ose zëvendësi që ka drejtuar mbledhjen.

### ***Neni 32***

#### ***Forma e votimit***

Vendimet merren me votime të hapura, përveç rasteve kur me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm vendoset ndryshe.

Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë, përveç rasteve kur me shumicë votash vendoset ndryshe.

### ***Neni 33***

#### ***Vlefshmëria e votës për të marrë vendime***

Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur ka barazim të votave, kryhet një votim i dytë. Nëse edhe në votimin e dytë përsëritet e njëjta situatë, vota e Presidentit është vendimtare.

## **PJESA E DYTË**

### **KOMISIONET E URDHHRIT**

#### ***Neni 34***

##### ***Komisionet Disiplinore***

Pranë Këshillit Kombëtar dhe këshillave rajonalë funksionojnë Komisionet Disiplinore. Komisionet Disiplinore janë organizma të gjykimit disiplinor profesional të pavarur. Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat për shkelje të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike, si edhe për kequshtrim profesioni dhe gabime mjekësore.

Komisionet Disiplinore pranë Këshillave Rajonalë ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre mund të apelojnë në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë dhe përfundimtare.

Këto Komisione Disiplinore funksionojnë në bazë të Rregullores së posaçme (për Gjykimin Disiplinor Profesional) e miratuar nga Këshilli Kombëtar.

#### ***Neni 35***

##### ***Anëtarët e komisioneve disiplinore***

Për të siguruar zhvillimin e një gjykimi profesional të pavarur, të drejtë dhe me kompetencë, përzgjedhja e anëtarëve të komisioneve disiplinore bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave të larta cilësore dhe kriterëve individuale të specifikuar në Rregulloren për Gjykimin Disiplinor Profesional.

#### ***Neni 36***

##### ***Kompetencat ndëshkimore***

Komisioni Disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet së anëtari ka kryer shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike, Ligjit dhe akteve të tjera kodifikuese lidhur me ushtrimin e profesionit, ai e shpall atë fajtor dhe i jep këto masa:

- a) Vërejtje me shkrim;
- b) Vërejtje me paralajmërim;

- c) Gjobë, nga 1.500 — 100.000 lekë;
- d) Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore.
- e) Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologëve deri në 3 (tre) vjet;
- f) Përfundim i përkohshëm nga Urdhri i Stomatologëve për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

Masa ndëshkuese e parashikuar në shkronjën “f” sjell si rrjedhojë çregjistrim nga Regjistri i Stomatologëve të Rajonit dhe ai Kombëtar, si dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit për afatin e caktuar në Vendimin Disiplinor.

Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, në qoftë se brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre për shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni, dhe brenda 3 (tre) vjetësh nga data e dhënies së tyre për shkronjat “d”, “e”, dhe “f”, ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

### ***Neni 37***

#### ***Detyrimi për kualifikimin profesional***

Përveç masave ndëshkuese, për stomatologët që nuk plotësojnë detyrimin e pjesëmarrjes në procesin e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor dhe nuk fitojnë kreditet e domosdoshme, komisionet disiplinore vendosin edhe detyrime me afate të përcaktuara për kualifikimin e nevojshëm profesional dhe të studimeve plotësuese me provimet përkatëse. Këto detyrime specifikohen nga një Komision i ngritur në bashkëpunim me QKEV-në. Shpenzimet përkatëse përballohen nga anëtari i ndëshkuar disiplinarisht.

### ***Neni 38***

#### ***Shpenzimet për proceset disiplinore***

Të gjitha shpenzimet për proceset disiplinore të kryera, përballohen nga USSH.

### ***Neni 39***

#### ***Ankimimi për vendimet disiplinore***

Ankimimi kundër vendimit për kalimin ose jo të ankesës në komision disiplinor nga ana e këshillit rajonal apo masave të marra nga Komisioni i Gjykimit Disiplinor të shkallës së parë bëhet në bazë të afateve të përcaktuara në Rregulloren për Gjykimit Disiplinor Profesional.

Për masat disiplinore të parashikuara në gërmat ‘c’, dhe ‘dh’ të nenit 35 të këtij Statuti, personi ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës.

### ***Neni 40***

#### ***Komisione të tjera dhe grupe pune (ad-hoc)***

Pranë Këshillit Kombëtar dhe këshillave rajonalë, në përputhje me problemet që lindin, krijohen komisione apo grupe pune të përhershme ose të përkohshme.

Veprimtaria e këtyre komisioneve bazohet në rregulloret përkatëse. Në pamundësi të ngritjes së Komisioneve apo të sektorëve të përhershëm, Aparati Qendror ngarkon me funksione të ndryshme individë nga Aparati, ose emëron të tjerë me kohë të plotë apo të reduktuar në punë (honorifik).

## **PJESA E TRETË**

### **ZGJEDHJET NË USSH**

#### **Neni 41**

##### ***Komisioni qendror i zgjedhjeve në USSH***

1. KQZ organizon e monitoron zgjedhjet periodike në USSH.
2. KQZ në USSH përbëhet nga 5 anëtarë të përhershëm.
3. Sekretari Përgjithshëm i USSH, kryeson Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në USSH.
4. Përgjegjësi i Sektorit të Liçensimit është anëtar i përhershëm në Komisionin Qendror të zgjedhjeve në USSH.
5. Përgjegjësi i Sektorit të Inspektim Monitorimit në USSH, është anëtar i përhershëm në komisionin qendror të zgjedhjeve në USSH.
6. Specialisti i IT në USSH është anëtar i përhershëm i Komisionit qendror të zgjedhjeve në USSH;
7. Sekretari i Këshillit Rajonal i USSH Tiranë, është anëtari i 5-të i KQZ në USSH.

#### **Neni 42**

##### ***Procesi zgjedhor për President të USSH***

Procedura e zgjedhjes së Presidentit të Këshillit Kombëtar:

1. Presidenti i Këshillit Kombëtar i U.S.SH-së, duhet të propozohet nga jo më pak se 20 % e anëtarëve të Asamblesë Kombëtare, kundrejt firmave përkatëse. Komisioni i verifikimit të mandateve i Asamblesë Kombëtare kualifikon dosjet e kandidatëve për president, që t'i propozohet për votim Këshillit Kombëtar;
2. Zgjedhja e Presidentit të Këshillit Kombëtar bëhet në të njëjtën ditë dhe datë me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar;

3. Thirrja e mbledhjes së Këshillit Kombëtar bëhet nga Presidenti në detyrë ndërsa Këshilli Kombëtar në mbledhjen e tij të parë do të drejtohet nga anëtari më i madh në moshë ose një anëtar tjetër i përfaqësuar në moshë;
4. Presidenti i USSH qëndron në detyrë derisa të bëjë betimin Presidenti i zgjedhur i USSH.
5. Dosjet e Stomatologëve që aplikojnë për tu zgjedhur President i Urdhri i Stomatologëve të Shqipërisë, administrohen nga Komisioni qendror zgjedhor dhe i dorëzohen me procesverbal të veçantë komisionit të Verifikimit të Mandateve në mbledhjen e parë të Asamblesë Kombëtare të USSH.
6. Ankimimet që bëhen gjatë të gjithë procesit zgjedhor, zgjidhen nga KQZ sipas parashikimit në rregulloren e procesit zgjedhor, të miratuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor në USSH.
7. Ankimimet ndaj vendimeve të KQZ zgjidhen në gjykatën administrative.
8. Presidenti i USSH, thërret mbledhjet e asambleve rajonale të USSH për zgjedhjet e këshillave rajonale të USSH.

### ***Neni 43***

#### ***Zv.Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH***

- 1- Zv.Presidenti duhet të plotësojë të gjitha kriteret që janë të përcaktuara në Statutin e USSH për tu zgjedhur anëtar i Këshillit Kombëtar.
- 2- Zv.Presidenti i Këshillit Kombëtar në USSH zgjidhet për një mandat 5 vjeçar. Mandati i tij mbaron në të njëjtin ditë e moment me atë të Presidentit të USSH:
  - a - Zv.Presidenti i USSH zgjidhet dhe shkarkohet me propozim të 1/3-tës të numrit të përgjithshëm të Këshillit Kombëtar (të 25 anëtarëve).
  - b - Zv.Presidenti shkarkohet me propozim të Presidentit të Këshillit Kombëtar të USSH.
- 3 - Zv.Presidenti i USSH zgjidhet dhe shkarkohet nga Këshilli Kombëtar i USSH me votim të fshehtë dhe kuti, me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar.
- 4 - Zv.Presidenti i USSH, merr ose caktohet në detyra të përkohëshme ose të përherëshme nga Presidenti i USSH.
- 5 -Zv.Presidenti i USSH kryen dhe zbaton të gjitha detyrat funksionale statutores dhe ligjore të deleguara me shkrim nga Presidenti i USSH.
- 6 -Zv. Presidenti i USSH nuk kufizohet në kandidimin e tij, përveç atyre të parashikuar në këtë Statut.

### ***Neni 44***

#### ***Procesi i licensimit në USSH***

- 1- Këshilli Kombëtar i USSH pajis me licencën 5 vjeçare për ushtrimin individual të profesionit në stomatologji, të gjithë të diplomuarit në stomatologji që aplikojnë për licensim dhe plotësojnë kriteret në



referencë të ligjit të posaçëm “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores për Liçensim të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

2 -Stomatologu me marrjen e liçensës për ushtrimin individual të profesionit në stomatologji, njëherësh bëhet dhe anëtar i USSH.

3 - Liçensa për ushtrimin individual të profesionit në stomatologji rinovohet çdo 5 vjet sipas kriterëve të Rregullores së Liçensimit të miratuar nga Këshilli Kombëtar i USSH.

4 - Në çdo rast që ndodh një vakum ose boshllëk në funksionimin e këshillit rajonal të USSH, procesi i riliçensimit kryhet nga zyra e liçensimit në USSH, me logon e Këshillit Kombëtar sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e Liçensimit.

## **PJESA E KATËRT**

### **FINANCAT**

#### ***Neni 45***

#### ***Buxheti***

Urdhri i Stomatologeve ka buxhetin e tij, të cilin e administron vetë në përputhje me Ligjin “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me rregulloren përkatëse. Burimet financiare të Urdhrit të Stomatologut janë:

- a) Kuotizacionet e anëtarëve;
- b) Tarifat e regjistrimit dhe të dhënies së Liçensës për ushtrimin individual të profesionit.
- c) Donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

***Të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të vep- rimitarisë, Urdhri i Stomatologeve i përdor për të përmbushur misionin e tij të caktuar në Ligjin për Urdhrin e Stomatologeve ve dhe në këtë Statut.***

Zyra Ekonomiko – Financiare funksionon pranë Aparatit Qendror. Veprimtaria e saj kryhet në përputhje me rregulloren e posaçme për këtë sektor të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

#### ***Neni 46***

#### ***Kuotizacionet***

- 1) Kuotizacioni mujor për anëtarët është i detyrueshëm. Masa e kuotizacionit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar.

2) Kur për një periudhë prej më shumë se një vit kalendarik, nuk shlyen kuotizacionet dhe nuk paraqitet arsye e justifikueshme, anëtarit i pezullohet anëtarësimi në USSH dhe Liçensa për ushtrimin individual të profesionit.

#### ***Neni 47***

#### ***Përdorimi i burimeve financiare***

Burimet financiare të Urdhrit përdoren për:

- a) Paga dhe honorare, ndihma në rast fatkeqesie për anëtarët dhe familjet e tyre, shpërblime për anëtarët e Urdhrit, komisionerë, ekspertë, grupe pune, si dhe për punonjësit e Aparatit.
- b) Aktivitete të ndryshme kulturore.
- c) Kontributin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve.
- d) Detyrimet me shtetin dhe të tretët, etj.
- e) Shpenzimet operative (kancelari, transport, ndërlidhje, energji, dieta, dokumentime fotografike, audiokaseta dhe videokaseta e të tjera).
- f) Organizim veprimtarish shkencore-profesionale e kualifikuese (konferenca, simpoziume, sesione, seminare, trajnime, etj.).
- g) Botime me karakter shkencor dhe informativ e promovues për Urdhrin.
- h) Investim dhe blerje mjetesh dhe pajisjesh pune.
- i) Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombetare, si dhe pritje e përcjellje delegacionesh të huaja.
- j) Ceremoni të ndryshme përkujtimore, promovuese, etj.

#### **KREU I PESTË**

#### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### ***Neni 48***

#### ***Emërtimi***

Emri i organizatës është:

**“URDHRI I STOMATOLOGËVE TË SHQIPËRISË”.**

**NENI 49**

Urdhri i Stomatologëve të Shqipërisë ka stemën dhe vulën e tij (Këshilli Kombëtar dhe këshillat rajonalë).

**Neni 50**

Rezidenca e Këshillit Kombëtar është në Tiranë.

**Neni 51**

USSH-ja mban llogari bankare në lekë dhe në valutë të huaj.

**Neni 52**

**Organi periodik**

USSH nxjerr Organin e tij periodik:

**“BULETINI I URDHRI TË STOMATOLOGËVE TË SHQIPËRISË”.**

**Neni 53**

**Praktika e amendimeve në Statut**

Me kërkesën e 1/3 të Këshillit Kombëtar të USSH, fillon procedura për ndryshimin e Statut dhe miratohen ndryshimet me 2/3 e të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Statuti i miratuar në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të USSH, me vendim nr.02, dt.14.04.2015, i ndryshuar me vendimin nr.prot.05, dt.09.09.2016, i ndryshuar me vendimin nr.prot.16, dt.06.12.2018, i ndryshuar me vendimin nr.prot.8, dt.19.10.2023.

**PRESIDENTI I USSH**

**Dr.Nikoll DEDA**